



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK

Nr 8473 . prot.

Himarë, më 18 . 11 . 2025

VENDIM

Nr. 14 datë 18.11 .2025

PËR MIRATIMIN E NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore“,neni 17,56 dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak,miratuar me VKB, Nr. 33 datë 28.07.2023 neni 27.
Kryesia e këshillit në mbledhjen e datës 18.11 .2025

VENDOSI:

- 1.Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e Këshillit Bashkiak e cila do të mbahet më datë 26.11 .2025.
- 2.Ngarkohet sekretari këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
- 3.Ngarkohet sekretari këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës si dhe materialet relevante të mbledhjes tek secili këshilltar ,tek kryetari Bashkisë,deputetët e qarkut,tek personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë ,si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltarë dhe tek kryetari Bashkisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

Mirza Gjireli

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

Ennio Ceo Berdhyllaj

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Ilhamir Jupq

[Signature]

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

Afronta Dhiogjoni

Anëtar i Kryesisë së Këshillit

Sekretar i Këshillit Bashkiak

[Signature]

[Signature]





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK

Lënda: Bashkëlidhur vendimit nr. 14, datë 18.11.2025, miratuar nga Kryesia e Këshillit Bashkiak ne mbledhjen e datës 04.08.2025 “Për miratimin paraprak të rendit ditës dhe përcaktimin e datës së mbledhjes për Këshillin Bashkiak , muaji nëntor

Kryesia e këshillit vendosi se mbledhja e muajit nëntor do të mbahet në datën 26.11.2025, ora 11:00, me rend dite si më poshtë:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për disa ndryshime në paketën fiskale të vitit 2022, miratuar me VKB nr. 54, datë 25.11.2021, ndryshuar me VKB nr. 34, datë 03.12.2024;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin e planit të masave për emergjencat civile në Bashkinë Himarë për periudhën vjeshtë-dimër 2025-2026”;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin mbi dhënien e bursës për arsimin e mesëm profesional, nxënësit z. Amarjo Adnant Bajramaj, për vitin shkollor 2025-2026”;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për propozimin për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 01-31 tetor 2025, nga fondi i kushtëzuar 6% i bllok ndihmës ekonomike;
5. Analizë me objekt “Realizimin e buxhetin për vitin 2025”, nga drejtoria e financës dhe planifikimit të buxhetit;
6. Informacion për hedhjen e mbetjeve të ngurta në Vishë, nga drejtoria e zhvillimit dhe planifikimit të territorit.
7. Të ndryshme.